



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër** Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

**Vendosi:** **Trupi Gjykses II**  
Gjykatës Çarls L. Smith, III, kryegjykatës  
Gjykatës Kristof Barte  
Gjykatës Ginel Metro  
Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 3 nëntor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**  
**Vendimit mbi Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në**  
**Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith  
Methju Halling  
Valeria Boliçi  
Xhejms Paç

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bauden  
Elinor Stivenson

**Mbrojtjes së Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman  
Karl Bakli  
Xhonatan Piter Uorbois

I.	HISTORIKU PROCEDURAL .....	2
II.	PARASHTRIMET .....	6
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	11
IV.	DISKUTIM .....	14
A.	Kërkesa e Gucatit për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve.....	14
B.	Rëndësia materiale sipas rregullës 102(3) dhe mbështetshmëria e provave.....	15
C.	Rëndësia materiale sipas rregullës 102(3) dhe pretendimet për shtytje për kryerje të veprës penale.....	19
D.	Materialet.....	22
1.	Materialet 185-190 dhe 192-194.....	22
2.	Materiali 191 .....	23
3.	Materialet 195-200.....	26
4.	Materiali 201 .....	28
E.	Marrja e mëtejshme në pyetje nga Mbrojtja.....	29
F.	Dymbëdhjetë pyetjet e Gucatit .....	29
G.	Kërkesat shtesë të Haradinajt .....	30
H.	Kërkesa plotësuese e Gucatit .....	32
V.	KLASIFIKIMI .....	33
VI.	VENDIM .....	34

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në pajtim me nenet 21(6) dhe 40(2) dhe 6(b) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 102(3) dhe 108 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 shtator 2021, Trupi Gjykues, duke marrë parasysh vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit të 29 korrikut 2021,<sup>1</sup> urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që, ndër të tjera, deri më 6 shtator 2021 të dorëzonte një njoftim të përditësuar të rregullës 102(3) me listën e materialeve në zotërim të ZPS-së që ishin objekt i konstatimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>2</sup> Po atë ditë, ZPS-ja kërkoi leje për të dorëzuar një kërkesë për masat mbrojtëse për t'u zbatuar në lidhje me çdo njoftim të përditësuar të rregullës 102(3).<sup>3</sup>

2. Më 2 shtator 2021, Trupi Gjykues dëgjoi parashtrimet me gojë të të dyja palëve në lidhje me njoftimin e përditësuar të rregullës 102(3),<sup>4</sup> përfshirë edhe parashtrime të ZPS-së në një seancë *ex parte*.<sup>5</sup> Pasi dëgjoi parashtrimet, Trupi Gjykues urdhëroi ZPS-në që deri më 3 shtator 2021, në orën 12:00, t'i dorëzonte vetëm Trupit Gjykues: (i) një version paraprak të paredaktuar të njoftimit të përditësuar të rregullës 102(3); dhe (ii) një propozim për versionin e redaktuar të së njëjtës listë.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> IA005-F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet Kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit* ("Vendimi mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Informacionit"), 29 korrik 2021.

<sup>2</sup> Urdhër Gojor në lidhje me Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3), 1 shtator 2021, f. 442-443 të transkriptit.

<sup>3</sup> Konferenca përgatitore për gjykimin, 1 shtator 2021, f. 443 e transkriptit.

<sup>4</sup> Konferenca përgatitore për gjykimin, 2 shtator 2021, f. 560-600 të transkriptit.

<sup>5</sup> Transkripti i seancës *ex parte*, f. 606-637.

<sup>6</sup> Urdhër Gojor në lidhje me Listën e ZPS-së sipas Rregullës 102(3), 2 shtator 2021, f. 638 e transkriptit.

3. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi versionin paraprak të përditësuar të rregullës 102(3) dhe një propozim për versionin e redaktuar të tij.<sup>7</sup>
4. Më 7 shtator 2021, Trupi Gjykes konstatoi se materialet në versionin paraprak të njoftimit të përditësuar të rregullës 102(3), të paktën në pamje të parë, dukeshin se ishin objekt i nxjerrjes sipas rregullave 102 dhe/ose 103 të Rregullores dhe, mbi këtë bazë, urdhëroi ZPS-në t'i përcillte Mbrojtjes një njoftim të përditësuar, të redaktuar, sipas rregullës 102(3) ("Urdhri lidhur me Rregullën 102(3)").<sup>8</sup>
5. Më 9 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi një njoftim të përditësuar të redaktuar konfidencial sipas rregullës 102(3) ("Njoftimi i Përditësuar i Rregullës 102(3)").<sup>9</sup>
6. Më 13 shtator 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit") dhe Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("Mbrojtja e Haradinajt") i kërkuan ZPS-së që të kishin qasje në të gjitha dokumentet e renditura në listën e Njoftimit të Përditësuar të Rregullës 102(3).<sup>10</sup>
7. Më 17 shtator 2021, ZPS-ja i paraqiti Trupit Gjykes një kërkesë për mosnxjerrjen e materialeve të kërkuara nga Mbrojtja ("F00316").<sup>11</sup>
8. Më 24 shtator 2021, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan përgjigjet përkatëse ndaj parashtrimit F00316 ("F00325/COR", "F00326").<sup>12</sup>

---

<sup>7</sup> F00296, Prokurori i Specializuar, *Redaktime të Propozuara të Prokurorisë në Njoftimin sipas Rregullës 102(3)*, 3 shtator 2021, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> F00304, Trupi Gjykes, *Urdhër lidhur me Njoftimin e Hollësishëm të Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("Urdhri lidhur me Rregullën 102(3)") me shtojcë konfidenciale dhe *ex parte*, 7 shtator 2021, para. 23, 26.

<sup>9</sup> F00307, Prokurori i Specializuar, *Shtesë e Njoftimit Përmbledhës të Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)* me shtojcë konfidenciale, 9 shtator 2021.

<sup>10</sup> F00316/COR, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtime të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("F00316"), 17 shtator 2021, para. 13. *Shih gjithashtu F00316/CONF/RED, konfidenciale, dhe F00316/RED, publike; F00325/COR, Mbrojtja e Gucatit, Version i Korrigjuar i Përgjigjes ndaj Versionit të Redaktuar Konfidencial të Kundërshtimeve të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("F00325/COR"), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 8.

<sup>11</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimi 10 (F00316).

<sup>12</sup> *Shih më lart*, poshtëshënimi 10 (F00325/COR); F00326, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kundërshtimeve të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("F00326"), 24 shtator 2021.

9. Më 28 shtator 2021, në vijim të urdhrit të Trupit Gjykses ("F00320"),<sup>13</sup> ZPS-ja i dorëzoi vetëm Trupi Gjykses parashtrime të mëtejshme për disa nga materialet e përfshira në listën e Njoftimit të Përditësuar të Rregullës 102(3), së bashku me katër kopje fizike të materialit 191 ("F00331").<sup>14</sup>

10. Më 29 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi një notë zyrtare rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("F00337") lidhur me një kontakt të kohëve të fundit me një dëshmitar.<sup>15</sup>

11. Më 4 tetor 2021, Trupi Gjykses mbajti një seancë *ex parte* vetëm me ZPS-në për të dëgjuar argumente të mëtejshme lidhur me parashtrimin F00337.<sup>16</sup> Mbrojtja u njoftua për mbajtjen e seancës por nuk iu dhanë hollësi për natyrën e materialeve që u diskutuan në atë seancë.

12. Më 7 tetor 2021, në vijim të seancës *ex parte*, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që të dorëzonte një shtesë të Njoftimit të Përditësuar të Rregullës 102(3) ("Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3)").<sup>17</sup>

13. Më 13 tetor 2021, ZPS-ja dorëzoi Shtesën e Njoftimit të Përditësuar të Rregullës 102(3), duke shtuar një material në listën e Shtojcës 1 të parashtrimit F00337 ("materiali 201").<sup>18</sup>

14. Më 18 tetor 2021, Trupi Gjykses i informoi palët se do të nxirrte një vendim përmbledhës mbi aspektet ende të patrajtuara të rregullës 102(3) sa më shpejt që të ishte e realizueshme, gjatë ose menjëherë pasi të kishte dëgjuar dëshmitë e

---

<sup>13</sup> F00320, Trupi Gjykses, *Urdhër për Parashtrim të Mëtejshëm në lidhje me Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("F00320"), 22 shtator 2021.

<sup>14</sup> F00331, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në pajtim me KSC-BC-2020-07-F00320* ("F00331"), 28 shtator 2021.

<sup>15</sup> F00337, Prokurori i Specializuar, *Përcjellje nga Prokuroria e Shënimit Zyrtar për Kontaktin dhe Kërkesë lidhur me Të, 29 shtator 2021, me dy shtojca rreptësisht konfidenciale dhe ex parte. Shtojca 1 e F00337-ës përmban një përmbledhje të kontaktit me një dëshmitar.*

<sup>16</sup> F00346, Trupi Gjykses, *Urdhër për Caktimin e Datës për Seancë Ex Parte*, 1 tetor 2021, konfidencial.

<sup>17</sup> F00354, Trupi Gjykses, *Urdhër për Shtesë të Njoftimit të Hollësishëm të Përditësuar të Rregullës 102(3)* ("Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3)"), 7 tetor 2021, konfidencial.

<sup>18</sup> F00361, Prokurori i Specializuar, *Përditësim i Prokurorisë i Shtesës së Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 13 tetor 2021, konfidencial.

dëshmitarëve W04841 dhe W04842. Trupi Gjykses vuri në dukje se kjo shtyrje ishte e domosdoshme sepse rëndësia materiale dhe nxjerrja e materialeve të rregullës 102(3) lidheshin ngushtë me pretendimet e Mbrojtjes se ZPS-ja kishte shtyrë të akuzuarit të kryenin vepër penale (“pretendimet për shtytje”) dhe sepse, në qoftë se dëshmitarët W04841 dhe W04842 do të mund të jepnin dëshmi lidhur me pretendimet për shtytje, dëshmitë e tyre mund të kishin ndikim në vendimin që do të merrej nga Trupi Gjykses.<sup>19</sup>

15. Më 21 tetor 2021, Trupi Gjykses mbajti një seancë tjetër *ex parte* vetëm me ZPS-në për të dëgjuar parashtrime mbi aspektet ende të pazgjidhura të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) dhe masat kompensuese të mundshme.<sup>20</sup> U bënë pyetje në veçanti për masat kompensuese në pajtim me rregullën 108(2) të Rregullores, të cilat janë të nevojshme për të garantuar drejtësinë e procesit dhe për t’i mundësuar Mbrojtjes të hetojë dhe të paraqesë provat dhe argumentet e veta lidhur me aspektin e “shtytjes për kryerje të veprës penale” në mënyrë të efektshme.<sup>21</sup>

16. Më 22 tetor 2021, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e saj për nxjerrjen e Shtesës së Njoftimit të Përditësuar të Rregullës 102(3) dhe bëri parashtrime në lidhje me masat kompensuese të propozuara (“F00389”).<sup>22</sup>

17. Më 27 dhe 29 tetor 2021, ekipet e Mbrojtjes dorëzuan përgjigjet përkatëse ndaj parashtrimit F00389 (“F00404”, “F00407”).<sup>23</sup>

---

<sup>19</sup> Transkripti, 18 tetor 2021, f. 816-817.

<sup>20</sup> F00382, Trupi Gjykses, *Urdhër për Caktimin e Datës për Seancë Ex Parte*, 19 tetor 2021, konfidencial, me shtojcë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>21</sup> Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1254-1256, 1265-1280, 1281-1289.

<sup>22</sup> F00389, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë për Nxjerrjen dhe Masa Kompensuese të Propozuara në lidhje me Njoftimin e Rregullës 102(3)* (“F00389”), 22 tetor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcë konfidenciale. *Shih gjithashtu F00389/CONF/RED*.

<sup>23</sup> F00404, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj ‘Kundërshtimit të Prokurorisë për Nxjerrjen dhe Masat Kompensuese të Propozuara në lidhje me Njoftimin e Rregullës 102(3)’* (“F00404”), 27 tetor 2021, konfidencial; F00407, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj ‘Versionit të Redaktuar Publik të Kundërshtimit të Prokurorisë për Nxjerrjen dhe Masat Kompensuese të Propozuara në lidhje me Njoftimin e Rregullës 102(3)’ dhe Kërkesë Plotësuese* (“F00407”), 29 tetor 2021, konfidenciale.

18. Më 1 nëntor 2021, ZPS-ja parashtrori kundërpërgjigje ndaj përgjigjeve të Mbrojtjes ("F00409").<sup>24</sup>

## II. PARASHTRIMET

19. Në parashtrimin F00316, ZPS-ja kërkon mosnxjerrjen e të gjashtëmbëdhjetë (16) materialeve të përfshira në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3) ("materialet 185-200").<sup>25</sup> ZPS-ja parashtron se asnjë prej këtyre materialeve nuk janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes, sepse Mbrojtja nuk ka argumentuar, dhe nuk mund të argumentojë, *prima facie* ekzistencën e shtytjes për kryerje të veprës penale që të përligjë nxjerrjen në këtë rast.<sup>26</sup> ZPS-ja parashtron se konstatimi *prima facie* i Trupit Gjykses në Urdhrin mbi Rregullën 102(3) nuk paragjykon konstatimin përfundimtar të tij lidhur me rëndësinë materiale, i cili mund të bëhet vetëm pasi Mbrojtja të ketë zgjedhur materialet nga Njoftimi i Përditësuar i Rregullës 102(3) dhe ZPS-ja të ketë pasur mundësi të plotë të kundërshtojë rëndësinë materiale të tyre.<sup>27</sup>

20. ZPS-ja parashtron më tej se nxjerrja e materialeve 185-200 do të cenonte hetimet aktuale dhe të ardhshme, do të shkaktonte rrezik të rëndë për sigurinë e dëshmitarëve dhe do të ndërlikonte së tepërmi aftësinë e ZPS-së për të kërkuar bashkëpunimin e shteteve të treta.<sup>28</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se materiali 191 përfshihet edhe në fushëveprimin e rregullës 106 të Rregullores.<sup>29</sup> Më tej, ZPS-ja parashtron se lista e pyetjeve që iu dorëzua fillimisht nga Mbrojtja e Gucatit më 3 mars 2021, të cilën Mbrojtja e Gucatit e dorëzoi përsëri më 21 prill 2021 dhe 13 shtator 2021 ("12 pyetjet e

---

<sup>24</sup> F00409, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Përgjigjeve ndaj Kundërshtimit për Nxjerrjen dhe Masat Kompensuese të Propozuara ("F00409")*, 1 nëntor 2021, konfidenciale.

<sup>25</sup> F00316, para. 1, 56.

<sup>26</sup> F00316, para. 16-17.

<sup>27</sup> F00316, para. 15.

<sup>28</sup> F00316, para. 22-43.

<sup>29</sup> F00316, para. 44-48.



Gucatit”)<sup>30</sup> dhe tri kërkesat shtesë të paraqitura nga Mbrojtja e Haradinajt (“kërkesat shtesë të Haradinajt”)<sup>31</sup> nuk janë të përligjura dhe nuk duhet të trajtohen më tej.<sup>32</sup>

21. Në parashtrimin F00325/COR, Mbrojtja e Guçatit përgjigjet se vlerësimi i Trupit Gjykses se materiali i kërkuar ishte *prima facie* objekt i nxjerrjes sipas rregullës 102(3) dhe/ose rregullës 103 të Rregullores ishte i drejtë dhe Trupi Gjykses duhet ta rrëzojë kërkesën e ZPS-së për mosnxjerrje sepse ZPS-ja nuk ka vërtetuar që në këtë rast janë të zbatueshme përjashtimet e parapara në rregullën 106 ose rregullën 108 të Rregullores.<sup>33</sup>

22. Në parashtrimin F00326, Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se standardi i rëndësisë materiale është përmbushur dhe ZPS-ja nuk ka demonstruar mjaftueshëm se nxjerrja shkakton rreziqe dhe se këto rreziqe nuk mund të trajtohen me anë të redaktimeve.<sup>34</sup>

23. Në parashtrimin F00389, ZPS-ja kërkon mosnxjerrjen e materialit 201, duke argumentuar se ky material është i ngjashëm për nga lloji me materialet 185-200, për mosnxjerrjen e të cilave ende pritet vendimi i Trupit Gjykses.<sup>35</sup>

24. ZPS-ja parashtron më tej se, ndonëse Trupi Gjykses konstatoi se në fazën e parë të sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) nuk bëhet vlerësim i mbështetshmërisë së materialeve apo provave në zotërim të ZPS-së, Trupi Gjykses nuk dha vendim të qartë mbi atë nëse natyra e hamendshme e provës mund të ndikojë në përcaktimin nëse informacioni është juridikisht thelbësor për përgatitjen e Mbrojtjes në fazën e dytë të sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3).<sup>36</sup>

---

<sup>30</sup> F00316, para. 7, poshtëshënimi 16; Shtojca 1.1, f. 5 përmban dymbëdhjetë pyetjet e parashtruara nga Mbrojtja e Guçatit në prill 2021, të cilat përsëriten nga ZPS-ja në parashtrimin F00190, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa dhe Kundërshtime të Prokurorisë në Pajtim me KSC-BC-2020-07-F00172*, 26 prill 2021, para. 34-36. *Shih më poshtë*, poshtëshënimi 115.

<sup>31</sup> F00316, para. 13, poshtëshënimi 25; Shtojca 1.2, f. 11 përmban tri kërkesa shtesë të Mbrojtjes së Haradinajt për nxjerrje materiale. *Shih më poshtë*, para. 85 dhe poshtëshënimet 120-122.

<sup>32</sup> F00316, para. 49-54.

<sup>33</sup> F00325/COR, para. 87-88.

<sup>34</sup> F00326, para. 35-38.

<sup>35</sup> F00389, para. 3.

<sup>36</sup> F00389, para. 5.



ZPS-ja është e mendimit se pranohet gjerësisht që informacioni “juridikisht thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes” duhet të ketë mundësi reale, përkundër mundësisë jorealiste, për të çuar drejt provave relevante apo aspekteve të reja të mundshme.<sup>37</sup> Mbi këtë bazë, ZPS-ja argumenton se “informacioni jorealist” gjithashtu nuk duhet të përfshihet në fushëveprimin e rregullës 103 të Rregullores. Më tej, ZPS-ja parashtrohet se cilësia e informacionit ndikon edhe në përcaktimin se cilat masa kompensuese janë të nevojshme, nëse do të jenë të nevojshme masa të tilla, në kuadër të fazës së tretë të kornizës për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores.<sup>38</sup> Sa i takon materialit 201, ZPS-ja parashtrohet se cilësia e informacionit në materialin 201 nuk është mjaftueshmërisht e lartë për të provuar apo rrëzuar ndonjë prej fakteve nën shqyrtim në këtë çështje gjyqësore, madje as sipas standardit *prima facie*, dhe për këtë arsye ai nuk mund të jetë juridikisht thelbësor për përgatitjen e Mbrojtjes.<sup>39</sup>

25. Më tej, ZPS-ja parashtrohet se nxjerrja e materialit 201 do të cenonte hetimet aktuale dhe të ardhshme, si edhe do të shkaktonte rreziqe të rënda për sigurinë e personit identiteti i të cilit do të bëhej i ditur nga nxjerrja e këtij materiali.<sup>40</sup>

26. Në parashtrimin F00389, ZPS-ja gjithashtu propozon masa kompensuese për mosnxjerrjen e materialeve 191, 195-200 dhe 201.<sup>41</sup> ZPS-ja bën të ditur se jep pëlqimin për këto masa vetëm në interes të zgjidhjes së aspektit ende të pazgjidhur në kuadër të rregullës 102(3), dhe me marrëveshjen që nuk do të kërkohen nxjerrje të tjera, me përjashtimin e mundshëm të një mase kompensuese të mëtejshme që ia ka paraqitur Trupit Gjyqësor për shqyrtim, dhe se këto masa nuk do të përdoren si bazë për përligjen e nxjerrjeve të mëtejshme.<sup>42</sup>

---

<sup>37</sup> F00389, para. 6, ku citohet jurisprudencë nga TPNJ-ja dhe GJPN-ja (poshtëshënimi 13).

<sup>38</sup> F00389, para. 6.

<sup>39</sup> F00389, para. 8.

<sup>40</sup> F00389, para. 9-10.

<sup>41</sup> F00389, para. 11-16.

<sup>42</sup> F00389, para. 12.

27. Në parashtrimin F00404, Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se materiali 201 është qartësisht juridikisht thelbësor për argumentet e Mbrojtjes dhe se i takon Trupit Gjykses të vlerësojë besueshmërinë dhe/ose peshën e informacionit në atë material dhe të vendosë nëse do ta pranojë atë provë.<sup>43</sup> Mbrojtja e Haradinajt gjithashtu parashtron se nuk i pranon masat kompensuese të propozuara nga ZPS-ja për materialet 191, 195-200 dhe 201.<sup>44</sup> Ajo argumenton më tej se është krejt e palejueshme që ZPS-ja të mbajë peng Mbrojtjen dhe/ose Trupin Gjykses duke u orvatur të japë ultimatum në lidhje me masat kompensuese të propozuara.<sup>45</sup> Mbrojtja e Haradinajt gjithashtu parashtron se, në qoftë se Trupi Gjykses e ka këqyrur përmbajtjen e materialit 201, atëherë edhe Mbrojtja duhet të ketë qasje në të.<sup>46</sup>

28. Në parashtrimin F00407, Mbrojtja e Gucatit përgjigjet se Mbrojtja e konsideron materialin 201 njëherazi juridikisht thelbësor për përgatitjen e saj dhe shfajësues.<sup>47</sup> Ajo argumenton më tej se rëndësia materiale e informacionit që përmban materiali 201 nuk është e hamendshme, sepse informacioni është i rëndësishëm dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me një aspekt ende të pazgjidhur në këtë çështje gjyqësore, konkretisht me pretendimet e shtytjes për kryerje të veprës penale.<sup>48</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e Gucatit është e mendimit se në parashtrimin F00389, të paktën në versionin e redaktuar të tij, nuk jepet asnjë hollësi lidhur me cenimin e hetimeve të ZPS-ë ose rreziqet e rënda për sigurinë e dëshmitarit.<sup>49</sup> Për sa u përket masave kompensuese të propozuara nga ZPS-ja lidhur me materialet 191, 195-200 dhe 201, Mbrojtja parashtron se ato nuk duhet të jenë aspekte që negocohen midis Trupit Gjykses dhe ZPS-së dhe se është e palejueshme që ZPS-ja të kërkojë të lirohet prej detyrimit në vazhdimësi për nxjerrjen e dokumenteve në shkëmbim të dhënies së “pëlqimit” të saj për masat kompensuese.<sup>50</sup>

---

<sup>43</sup> F00404, para. 9-10, 15-16.

<sup>44</sup> F00404, para. 27.

<sup>45</sup> F00404, para. 25.

<sup>46</sup> F00404, para. 34-42.

<sup>47</sup> F00407, para. 5.

<sup>48</sup> F00407, para. 6-10.

<sup>49</sup> F00407, para. 17.

<sup>50</sup> F00407, para. 20.

Mbrojtja e Gucatit gjithashtu parashtron se nuk është në gjendje të komentojë për masat kompensuese të propozuara duke pasur parasysh redaktimet në masë që i janë bërë versionit të redaktuar konfidencial të parashtrimit F00389.<sup>51</sup> Pavarësisht nga kjo, Mbrojtja e Gucatit kërkon që materialet të nxirren të plota ose në mënyrë të kufizuar si masë kompensuese.<sup>52</sup>

29. Mbrojtja e Gucatit kërkon gjithashtu që transkripti i seancës *ex parte* të 21 tetorit 2021 të riklasifikohet si konfidencial (“Kërkesa Plotësuese e Gucatit”).<sup>53</sup>

30. Në parashtrimin F00409, ZPS-ja kundërpërgjigjet se sipas jurisprudencës lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”) pretendimet për shtytje nuk duhet të jenë “tërësisht të pamundshme”.<sup>54</sup> Mbi këtë bazë, ZPS-ja është e mendimit se, ndonëse Trupi Gjykues konstatoi se cilësia e informacionit nuk ishte relevante për përfshirjen e materialeve në listën e Njoftimit të Rregullës 102(3), në qoftë se shtytja është tërësisht e pamundshme, atëherë nxjerrja e materialit është e papërligjur, në bazë të formulimeve të qarta të Rregullores dhe të GJEDNJ-së. Thjesht hamendjet nuk mund të jenë juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes.<sup>55</sup> ZPS-ja parashtron më tej se në dëshmitë e W04841-shit dhe W04842-shit nuk ka asgjë që të përlligjë nxjerrjen sa u takon pretendimeve për shtytje.<sup>56</sup>

31. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se masat kompensuese të propozuara nga ZPS-ja nuk e mbajnë peng Trupin Gjykues dhe se ato janë kalibruar në mënyrë të tillë që t’i japin Mbrojtjes informacion të mëtejshëm, duke mbrojtur në të njëjtën kohë interesat konkurruese që favorizojnë mosnxjerrjen.<sup>57</sup> ZPS-ja mendon se, nëse ajo do t’i ofronte

---

<sup>51</sup> F00407, para. 21.

<sup>52</sup> F00407, para. 23, 28(a)-(b).

<sup>53</sup> F00407, para. 24-26, 28(c).

<sup>54</sup> F00409, para. 3.

<sup>55</sup> F00409, para. 4.

<sup>56</sup> F00409, para. 6-9.

<sup>57</sup> F00409, para. 10.

këto masa vetëm si hapa kalimtarë për nxjerrje të mëtejshme, kjo do të binte ndesh me vendosjen e drejtpeshimit midis këtyre interesave.<sup>58</sup>

32. Sa i takon Kërkesës Plotësuese të Gucatit, në parashtrimin F00409, ZPS-ja argumenton se nuk ka asnjë bazë për riklasifikimin e seancës *ex parte* të 21 tetorit 2021, sepse përmendjen e kësaj seance ZPS-ja e bëri në pajtim me urdhrin e Trupit Gjykses të 17 shtatorit 2021 mbi zhvillimin e gjykimit (“Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit”).<sup>59</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

33. Neni 21(6) i Ligjit përcakton se të gjitha provat apo faktet materiale dhe relevante që posedon Zyra e Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj dhe janë objekt vetëm i atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kompensuese.

34. Sipas rregullës 102(3) të Rregullores, Prokurori i Specializuar, bazuar në nenin 21(6) të Ligjit, i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. Me kërkesë të Mbrojtjes, Prokurori i Specializuar i vë në dispozicion Mbrojtjes çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit të Specializuar, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë apo i përkisnin të akuzuarit. Nxjerrja e materialeve dhe provave të tilla bëhet pa vonesë. Prokurori i Specializuar i drejtohet menjëherë trupit gjykses në qoftë se ekzistojnë arsye për kundërshtimin e rëndësisë materiale të informacionit të lartpërmendur.

35. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe të Panelit të Gjykatës së Apelit se sistemi i nxjerrjes së materialeve në Dhomat e Specializuara (“DHS”) është i ndryshëm nga ai i gjykatave penale ndërkombëtare (të

<sup>58</sup> F00409, para. 10.

<sup>59</sup> F00409, para. 2, që i referohet parashtrimin F00314, Trupi Gjykses, Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit, 17 shtator 2021.

ndërkombëtarizuara).<sup>60</sup> Në veçanti, rregulla 102(3) e Rregullores dallon nga dispozitat e barasvlershme në rregulloret e procedurës dhe të provave në TPNJ dhe GJPN, në kuptimin që ajo: (i) kërkon hartimin e një njoftimi të hollësishëm nga Prokuroria përpara paraqitjes së kërkesave nga Mbrojtja; (ii) përcakton shprehimisht se ajo çka është juridikisht thelbësore për Mbrojtjen duhet të gjykohet si e tillë nga Mbrojtja; dhe (iii) parasheh që kundërshtimet lidhur me rëndësinë materiale duhet të ngrihen nga ZPS-ja.<sup>61</sup> Për më tepër, neni 21(6) i Ligjit e bën të qartë se sistemi i nxjerrjes së materialeve në DHS bazohet në supozimin e detyrimit për nxjerrje, me përjashtimet e kufizuara që përcaktohen në Rregullore. Gjithashtu, i takon ZPS-së dhe jo Mbrojtjes që të vërtetojë ekzistencën e një përjashtimi nga detyrimi i përgjithshëm i saj për nxjerrjen e materialeve.<sup>62</sup>

36. Trupi Gjykses rikujton gjithashtu se sistemi i nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores është një sistem me tri faza.<sup>63</sup> Faza e parë është një hap praktik dhe procedural me të cilin ZPS-ja informon Mbrojtjen për materialet që ka në zotërim, në mënyrë që Mbrojtja të jetë në gjendje: (i) të përcaktojë në mënyrë të njëmendte se cilat nga materialet e renditura në njoftim mund të jenë juridikisht thelbësore për të; dhe (ii) t'i paraqesë kërkesë ZPS-së për nxjerrjen e këtyre materialeve.<sup>64</sup>

37. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se shprehja “juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes” duhet të interpretohet gjerësisht dhe u referohet të gjitha dokumenteve dhe objekteve që janë të rëndësishme për përgatitjen e çështjes nga Mbrojtja, në ushtrim të të drejtave të të akuzuarit sipas

---

<sup>60</sup> Vendimi mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Informacionit, para. 39-40; F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar Sipas Rregullës 102(3) dhe Çështje në Lidhje me Të (“Vendimi mbi Materialin sipas Rregullës 102(3)”), 1 prill 2021, para. 23, poshtëshënimi 29.

<sup>61</sup> Vendimi mbi Materialin sipas Rregullës 102(3), poshtëshënimi 29.

<sup>62</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 15.

<sup>63</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 16; Vendimi mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Informacionit, para. 39; Vendimi mbi Materialin sipas Rregullës 102(3), para. 22.

<sup>64</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 16.

Ligjit dhe Rregullores. Çfarë është juridikisht thelbësore nuk duhet detyrimisht të kufizohet nga kuadri kohor i aktakuzës dhe as nuk duhet të kufizohet vetëm në materialin relevant për kundërshtimin e provave të ZPS-së. Po kështu, “përgatitja” e Mbrojtjes është koncept i gjerë dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në atë që lidhet drejtpërdrejt me provat shfajësuese apo inkriminuese, apo me provat e paraqitura nga ZPS-ja.<sup>65</sup>

38. Pasi Mbrojtjes i është dhënë mundësia të përcaktojë rëndësinë materiale bazuar në njoftimin sipas rregullës 102(3), vihet në lëvizje faza e dytë e procesit, pra faza kur Mbrojtja i kërkon ZPS-së nxjerrjen e materialeve relevante.<sup>66</sup> Kjo i hap rrugën fazës së tretë të procesit, në të cilën ZPS-ja mund t’i paraqesë Trupit Gjykses kundërshtimin e saj ndaj pretendimit lidhur me rëndësinë materiale, ose të kërkojë mosnxjerrjen e materialit që përndryshe duhet të nxirret në pajtim me rregullat 105, 107 ose 108 të Rregullores. Megjithatë, çdo kundërshtim i tillë duhet të mbajë parasysht rëndësinë që ka nxjerrja e materialit për drejtësinë e procesit si edhe faktin që sistemi i nxjerrjes në fuqi në DHS është një sistem që bazohet në supozimin e detyrimit të nxjerrjes së materialit relevant.<sup>67</sup>

39. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet se faza e parë e sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores nuk përfshin vlerësimin e mbështetshmërisë së materialit apo të provave në zotërim të ZPS-së.<sup>68</sup> Termi “material” mund të përfshijë çdo informacion, ide, të dhënë, ose dokument që vjen nga një dëshmitar apo burim tjetër, pavarësisht nëse ai informacion ka ndonjë bazë faktike.<sup>69</sup> Burimi, saktësia, mbështetshmëria ose subjektiviteti i informacionit që

<sup>65</sup> Vendimi mbi Materialin sipas Rregullës 102(3), para. 24, që i referohet F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me To*, 22 janar 2021, para. 45.

<sup>66</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 20.

<sup>67</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 20.

<sup>68</sup> Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3), para. 8.

<sup>69</sup> *Shih* B. A. Garner (ed.), *Black’s Law Dictionary*, 11<sup>th</sup> edition, 2019, ku termi “material” përkufizohet si “informacion, ide, të dhëna, dokumente ose sende të tjera që përdoren në raporte, libra, filma, studime, etj.”

zotëron ZPS-ja mund të shërbejë si bazë për vlerësimin e pranueshmërisë së provave përkatëse apo peshës që do t'u jepet nëse pranohen, por jo si bazë për të vendosur nëse Mbrojtja duhet të njoftohet për materiale të tilla sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Rregullorja nuk parasheh mundësinë që ZPS-ja të mos bëjë njoftim për informacionin që ka në zotërim për arsye që lidhen me mbështetshmërinë ose besueshmërinë.<sup>70</sup>

#### IV. DISKUTIM

##### A. KËRKESA E GUCATIT PËR SHTIMIN E NUMRIT TË LEJUAR TË FJALËVE

40. Mbrojtja e Gucatit bën kërkesë që për parashtrimin F00325/COR t'i lejohen më shumë se numri i paraparë prej 6000 fjalësh.<sup>71</sup> Trupi Gjykues vëren se Përgjigja e Gucatit e kalon këtë numër me 561 fjalë dhe se kërkesa për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve u paraqit në poshtëshënimin e fundit në të njëjtin parashtrim. Trupi Gjykues i rikujton Mbrojtjes së Gucatit se, në pajtim me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara ("Udhëzuesi i Punës"), kërkesat për tejkalimin e numrit të fjalëve duhet të bëhen "mjaftueshmërisht në kohë", duke dhënë arsye bindëse për nevojën e tejkalimit të numrit të lejuar. Përmendja nga Mbrojtja e Gucatit e "rëndësisë së çështjes së trajtuar" në të njëjtin parashtrim për të cilin kërkon edhe shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, nuk u përmbahet kritereve të nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës. Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykues, bazuar në nenin 36(3) të Udhëzuesit të Punës dhe për të mbrojtur interesat e të akuzuarit, bën një përjashtim dhe *proprio motu* e pranon Përgjigjen e Gucatit si të vlefshme. Gjithsesi, Trupi Gjykues e paralajmëron Mbrojtjen e Gucatit se mospërmbushjet prej saj të kritereve të nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës në të ardhmen nuk do të pranohen.

---

<sup>70</sup> Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3), para. 8.

<sup>71</sup> F00325/COR, poshtëshënimi 55.



**B. RËNDËSIA MATERIALE SIPAS RREGULLËS 102(3) DHE MBËSHTETSHMËRIA E PROVAVE**

41. Trupi Gjykues do të trajtojë fillimisht argumentin e ZPS-ë se natyra e hamendshme e provave mund të ketë ndikim në detyrimin e ZPS-së për nxjerrjen e materialeve sipas rregullave 102(3) dhe 103 të Rregullores.<sup>72</sup> ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykues nuk dha vendim të qartë mbi atë nëse natyra e hamendshme e provës mund të ndikojë në përcaktimin nëse informacioni ka rëndësi materiale për përgatitjen e Mbrojtjes në fazën e dytë të sistemit për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(3).<sup>73</sup> ZPS-ja parashtron se ky argument nuk bie ndesh, dhe në fakt nuk mund të bjerë ndesh, me urdhrin e Trupit Gjykues, duke pasur parasysh se fazat e kornizës statutoire të nxjerrjes i japin ZPS-së të drejtën të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave të caktuara në Njoftimin e Rregullës 102(3).<sup>74</sup> Në këtë drejtim, ZPS-ja parashtron se pranohet gjerësisht që informacioni “juridikisht thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes” duhet të ketë mundësi reale, përkundër mundësisë jorealiste, për të çuar drejt provave relevante apo aspekteve të reja të mundshme.<sup>75</sup> Po kështu, informacioni jorealist nuk duhet të përfshihet në fushëveprimin e rregullës 103.<sup>76</sup>

42. Për sa i përket sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores, Trupi Gjykues i kujton ZPS-së se është *Mbrojtja* ajo që vendos, në kuadër të fazës së dytë, se çfarë është juridikisht thelbësore për përgatitjen e saj. Ndonëse ZPS-ja mund të kundërshtojë rëndësinë materiale të informacionit në fazën e tretë të sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3), nuk i takon ZPS-së të mos e japë informacionin bazuar në përcaktimin e njëanshëm prej saj se prova është e hamendshme apo se informacioni nuk është mjaftueshmërisht i mbështetshëm. Trupi Gjykues ka përcaktuar shprehimisht se njoftimi i ZPS-së dhe detyrimi i saj për *nxjerrjen e informacionit* sipas rregullës 102 të Rregullores zbatohet edhe nëse ZPS-ja mendon që

---

<sup>72</sup> F00389, para. 5-6.

<sup>73</sup> F00389, para. 5.

<sup>74</sup> F00389, para. 6.

<sup>75</sup> F00389, para. 6.

<sup>76</sup> F00389, para. 6.

materiali në fjalë është i rremë ose çorientues.<sup>77</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykes konstatoi se parimi bazë i sistemit të nxjerrjes së materialeve që zbatohet në DHS është se informacioni që përfshihet në rregullën 102 të Rregullores duhet të nxirret, përveç nëse zbatohet ndonjë prej përjashtimeve të parapara në rregullat 105, 106, 107 ose 108 të Rregullores.<sup>78</sup>

43. Sa i takon rregullës 103 të Rregullores, Trupi Gjykes vëren se kjo dispozitë kërkon nxjerrjen e menjëhershme të çdo informacioni nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së “për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar”. Shprehja “ka arsye të besohet se sugjeron” kërkon zbatimin e një standardi objektiv i cili nuk përfshin vlerësimin e peshës ose mbështetshmërisë së materialit apo të besueshmërisë së dëshmitarit. Në vend të kësaj, ajo do të thotë “ka gjasa”, në kuptimin që ka lidhje të mjaftueshme thelbësore me një faktor apo rrethanë lehtësuese apo shfajësuese.<sup>79</sup> E thënë thjesht, shprehja “ka arsye të besohet se sugjeron” do të thotë se informacioni në fjalë duhet të orientojë, në një farë mënyre të logjikshme, drejt pafajësisë ose lehtësimit të fajësisë së të akuzuarit, pavarësisht nëse ZPS-ja e gjykon informacionin të mbështetshëm, apo “jorealit”. Një konstatim i kundërt do t’i jepte ZPS-së të drejtën të mos i bënte të ditura provat shfajësuese, çka do të përbënte shkelje të së drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe të parimit të barazisë së palëve.

44. Trupi Gjykes vëren më tej se jurisprudenca e TPNJ-së dhe GJPN-së e cituar nga ZPS-ja në parashtrimin F00389, nuk e mbështet pikëpamjen e ZPS-së për arsyet në vijim. Së pari, sikurse përmendet më lart, dispozitat e TPNJ-së dhe GJPN-së mbi nxjerrjen e provave juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes bazohen në një

<sup>77</sup> Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3), para. 10.

<sup>78</sup> Urdhri për Shtesë sipas Rregullës 102(3), para. 10.

<sup>79</sup> Ngjashëm, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, Trial Chamber, [Decision Denying Merhi Defence Motion Shihking Disclosure of Material Relating to Potential Users of Purple Phone 231](#), 13 September 2017, para. 34; *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, Trial Chamber, [Decision Dismissing Sabra Defence Application for Disclosure of Material Related to Mr Michael Taylor](#), 14 June 2018, para. 13.

parim të ndryshëm, sipas të cilit detyrimi për vënien në lëvizje të procesit të nxjerrjes i takon Mbrojtjes. Në sistemet e TPNJ-së dhe GJPN-së, rëndësinë materiale e përcakton Prokuroria ndërsa Mbrojtjes i jepet mundësia të kundërshtojë vlerësimin e mbështetshmërisë së informacionit që ka bërë Prokuroria.<sup>80</sup> Ky dallim kushtëzon shkallën në të cilën mund të jetë relevante jurisprudenca e TPNJ-së ose e GJPN-së në sistemin e nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(3) të Rregullores.

45. Së dyti, vendimet në të cilat bazohet ZPS-ja nuk mbështesin parimin për të cilin janë cituar. Jurisprudenca përkatëse e TPNJ-së thotë si vijon:

Materiali i kërkuar [nga Mbrojtja] në bazë të rregullës 66(B) [të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së] duhet: (i) të ketë lidhje ose të ketë gjasa të ketë lidhje me një aspekt të çështjes gjyqësore; (ii) të ngrejë ose të ketë gjasa të ngrejë një aspekt të ri, ekzistenca e të cilit nuk është e dukshme nga provat që propozon të përdorë Prokuroria; dhe (iii) *duhet të ketë mundësi reale, përkundër mundësisë jorealiste, për të çuar drejt provave në kuadër të (i) ose (ii)* [theksimi i shtuar].<sup>81</sup>

46. Rrjedhimisht, sipas këtij standardi, ajo çka duhet të jetë “reale” dhe jo “jorealiste”, është mundësia që materiali ose informacioni në fjalë të çojë në prova që kanë lidhje, ose kanë gjasa të kenë lidhje me një aspekt ekzistues ose të ngrejë, apo të ketë gjasa të ngrejë, një aspekt të ri në çështjen gjyqësore. Ky standard nuk do të thotë, siç parashtron ZPS-ja, se duhet kryer vlerësim i mbështetshmërisë apo peshës së informacionit përpara nxjerrjes së tij. Me fjalë të tjera, informacioni i kërkuar duhet të ketë “më shumë se sa [...] një lidhje logjike abstrakte me aspektet e çështjes gjyqësore”.<sup>82</sup> Cilësia e informacionit – në kuptimin e mbështetshmërisë së tij – nuk është relevante në këtë vlerësim.

<sup>80</sup> *Shih* rregulla 66(B) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së; ICC, *Rules of Procedure and Evidence, Rule 77*.

<sup>81</sup> ICTY, *Prosecutor v Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision On Accused's Motion To Compel Inspection Of Witness Material \(Christian Nielsen\) And Prosecution's Motion To Reclassify Public Motion](#), 7 July 2011, para. 6; *Prosecutor v Stanišić and Simatović*, IT-03-69-T, Trial Chamber, [Decision on Stanišić Request for Order of Disclosure of Materials Related to the Admissibility of the Expert Report of Reynaud Theunens](#), 11 March 2011, para. 12; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Decision on Motion by the Accused Zejnil Delalić for the Disclosure of Evidence](#), 26 September 1996, para. 6-7.

<sup>82</sup> TPNJ, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Decision on Motion by the Accused Zejnil Delalić for the Disclosure of Evidence](#), 26 September 1996, para. 7.

47. Sa i takon vendimit të GJPN-së të cituar nga ZPS-ja, Trupi Gjykes vëren se në të konstatohet që “sipas mendimit të Dhomës, rëndësia materiale e sugjeruar është e hamendshme dhe hipotetike”.<sup>83</sup> Pra vendimi nuk përmban asnjë sugjerim se nxjerrja do të kushtëzohej nga ndonjë vlerësim i mbështetshmërisë së vetë informacionit apo i besueshmërisë së dhënësit të informacionit. Në vend të kësaj, ky konstatim vlerëson lidhjen logjike ndërmjet informacionit në fjalë dhe një aspekti juridikisht thelbësor për Mbrojtjen.

48. Për këto arsye, Trupi Gjykes i hedh poshtë parashtrimet e ZPS-së lidhur me natyrën e sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103 të Rregullores. Për më tepër, ky interpretim ligjor i parashtruar nga ZPS-ja në këtë proces gjyqësor shkakton tek Trupi Gjykes shqetësimin lidhur me përmbushjen e plotë të detyrimeve të nxjerrjes nga ZPS-ja. Nisur nga kjo, Trupi Gjykes i rikujton ZPS-së detyrimin e saj në vijimësi për të kryer rishikim të plotë dhe të efektshëm të materialeve që posedon në përputhje me Rregulloren. Mosnxjerrja e materialit të paraparë në rregullën 102(3) ose rregullën 103 të Rregullores bazuar në vlerësimin e njëanshëm të ZPS-së për besueshmërinë ose mbështetshmërinë (ose mungesën e besueshmërisë dhe të mbështetshmërisë), do të trajtohet me rreptësinë më të madhe nga Trupi Gjykes. Trupi Gjykes thekson se nxjerrja e informacionit përbën element thelbësor dhe themelor për garantimin e gjykimit të drejtë. Trupi Gjykes e paralajmëron ZPS-në se detyrimet për nxjerrjen e informacionit që burojnë nga kjo garanci nuk janë detyra që mund të anashkalohen përmes sofizmave, por detyrime ligjore që duhen përmbushur me kujdesin, urgjencën dhe zellin më të madh.

---

<sup>83</sup> ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, Trial Chamber X, [Public Redacted Version of ‘Decision on the Defence Request to Terminate the Proceedings and Related Requests’](#), ICC-01/12-01/18-1009-Red, 24 August 2020 (data e origjinalit), para. 37.

### C. RËNDËSIA MATERIALE SIPAS RREGULLËS 102(3) DHE PRETENDIMET PËR SHTYTJE PËR KRYERJE TË VEPRËS PENALE

49. Përpara se të trajtojë materialet 185-201, Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të bëjë një numër qartësimesh lidhur me marrëdhënien midis “rëndësisë materiale” sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe pretendimeve të shtytjes për kryerje të veprës penale.

50. ZPS-ja parashtron se Mbrojtja ka të drejtën të argumentojë në favor të mbrojtjeve të pretenduara afirmuese në gjykim, por, për të marrë përmes nxjerrjes materialet që lidhen me këto mbrojtje, ajo duhet të vërtetojë *prima facie* se mbrojtja nuk është “tërësisht e pamundshme”.<sup>84</sup> ZPS-ja argumenton gjithashtu se pyetjet e paraqitura nga Mbrojtja e Gucatit në lidhje me autorin e Paketës 3, hollësitë se kush dhe si kishte qasje në atë paketë në ZPS, dhe se cilat aspekte hetoi apo nuk hetoi ZPS-ja, nuk përbëjnë vërtetim *prima facie* të pretendimeve për shtytje.<sup>85</sup> Mbrojtja e Gucatit përgjigjet se, për të marrë materialin relevant nga Prokuroria, i akuzuari nuk është i detyruar të demonstrojë *prima facie* se pretendimet për shtytje nuk janë tërësisht të pamundshme.<sup>86</sup> Mbrojtja e Gucatit parashtron se vendimi i Trupit Gjykues lidhur me atë nëse pretendimet për shtytje janë ose jo tërësisht të pamundshme dhe ndikimi i kësaj mbi detyrimin e provës përcaktohet gjatë gjykimit, pasi të jetë bërë nxjerrja e plotë dhe palët të kenë pasur mundësi të paraqesin plotësisht argumentet e tyre.<sup>87</sup>

51. Trupi Gjykues rikujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se rrethanat në të cilat materialet e sekuestruara nga ZPS-ja erdhën në zotërim të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) janë “relevante” për qëllimet e renditura në rregullën 102(3) të Rregullores.<sup>88</sup>

---

<sup>84</sup> F00316, para. 16.

<sup>85</sup> F00316, para. 17.

<sup>86</sup> F00325/COR, para. 59.

<sup>87</sup> F00325/COR, para. 60.

<sup>88</sup> Vendimi mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Informacionit, para. 47.

52. Trupi Gjykues rikujton gjithashtu standardin e vendosur nga Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me pretendimet për shtytje:

[s]ipas jurisprudencës së [GJEDNJ-së], parashtruesit e kërkesave duhet të jenë efektivisht në gjendje që gjatë gjyimit të tyre të ngrenë pretendim për nxitje, në pajtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"). Rrjedhimisht, organet e prokurorisë duhet të nxjerrin informacionin që ka lidhje me shtytjen për t'i mundësuar Mbrojtjes që të bëjë argumentimin e plotë të pretendimit për shtytje në gjykim, përndryshe procesi nuk do të jetë në përputhje me parimet e procesit ballafaques dhe të barazisë së palëve, si edhe me të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, në shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së. Sidoqoftë, Paneli vëren se pretendimet e të pandehurit për shtytje nuk duhet të jenë 'tërësisht të pamundshme'.<sup>89</sup>

53. Këtë jurisprudencë Trupi Gjykues e interpreton se do të thotë që ai ka detyrimin që gjatë gjyimit të shqyrtojë pretendimet për shtytje për të përcaktuar nëse pretendimet janë, sipas formulimit të GJEDNJ-së, "tërësisht të pamundshme". Nëse Trupi Gjykues mendon se pretendimet nuk janë tërësisht të pamundshme, atëherë ai duhet të shqyrtojë nëse ZPS-ja e ka përmbushur detyrimin e provës në lidhje me këto aspekte.<sup>90</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se vendimi i tij do të varet nga provat që do të paraqiten gjatë gjyimit. Për këto arsye, Trupi Gjykues vlerëson se është e parakohshme që të vendosë në këtë fazë nëse pretendimet për shtytje janë tërësisht të pamundshme. Mbrojtja duhet të lejohet të marrë, në kuadër të procesit të nxjerrjes, informacione relevante dhe të nxjerrshme që mund të jenë në favor të pretendimeve për shtytje, në mënyrë që të kryejë hetime të efektshme për to dhe të kërkojë dhe të marrë prova nga ata dëshmitarë që janë në gjendje të dëshmojnë në lidhje me to.

54. Gjithashtu, Trupi Gjykues është tejet i vetëdijshëm se i kërkohet të marrë vendime mbi rëndësinë materiale të informacionit në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores lidhur me pretendimet për shtytje ndërkohë që Mbrojtja nuk ka qasje në materialin përkatës.<sup>91</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të qartësojë

<sup>89</sup> Vendimi mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Informacionit, para. 52.

<sup>90</sup> Transkripti, 18 tetor 2021, f. 816.

<sup>91</sup> Shih ECtHR, *Edwards and Lewis v UK*, nos. 39647/98 and 40461/98, [Judgment](#), 27 October 2004.



parametrat në bazë të të cilëve bëri vlerësimin e rëndësisë materiale të materialeve 185-201.

55. Trupi Gjykues vëren se konstatimi i tij *prima facie* në Urdhrin mbi Rregullën 102(3), se materialet 185-190 dhe 192-200 duket se janë objekt i nxjerrjes sipas rregullave 102 dhe/ose 103 të Rregullores u bë: (i) në kuadër të fazës së parë të sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3); dhe (ii) në kushtet kur Trupi Gjykues nuk i kishte inspektuar materialet.<sup>92</sup> Kjo nuk e pengon ZPS-në të kundërshtojë rëndësinë materiale të informacionit në fazën e tretë të sistemit të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(3).

56. Në vlerësimin e tij në kuadër të fazës së tretë, Trupi Gjykues u shpreh se, në kontekstin e pretendimeve për shtytje, informacioni është juridikisht thelbësor sipas nenit 102(3) të Rregullores nëse: (i) informacioni mund të ndihmojë pretendimin e Mbrojtjes ose hetimet e saj në lidhje me shtytjen (pa u bërë vlerësimi i peshës, mbështetshmërisë ose besueshmërisë së atij informacioni); ose (ii) informacioni, i interpretuar në kontekstin përkatës, sugjeron se ZPS-ja nuk ndërmori hapat e duhur hetimorë për të përjashtuar mundësinë se një punonjës i saj, ose dikush nën kontrollin e saj, i shtyu të akuzuarit të kryenin vepër penale duke u dhënë atyre informacionin në fjalë.

57. Së treti, Trupi Gjykues shqyrtoi gjithashtu nëse ndonjë prej informacioneve në materialet 185-201 përmbante prova të mëtëjshme inkriminuese ose shfajësuese, ose nëse kishte ndonjë mundësi të çonte drejt provave që (kishin gjasë të) kishin lidhje me një aspekt ekzistues ose (kishin gjasë të) ngrinin një aspekt të ri në këtë çështje gjyqësore.

---

<sup>92</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 11-12, 23-24.



## D. MATERIALET

### 1. Materialet 185-190 dhe 192-194

58. Trupi Gjykses vëren se: (i) materiali 185 është një përmbledhje [REDAKTUAR];<sup>93</sup> (ii) materialet 186-190 janë [REDAKTUAR];<sup>94</sup> dhe (iii) materialet 192-194 janë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>95</sup>

59. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të këtyre materialeve, Trupi Gjykses mendon se ato nuk përmbajnë asnjë informacion që mund të ndihmojë pretendimin e Mbrojtjes ose hetimet e saj në lidhje me shtytjen. Po kështu, këto materiale nuk përmbajnë ndonjë informacion ose provë që sugjeron se ZPS-ja nuk kishte ndërmarrë hapat e duhur hetimorë për të përjashtuar mundësinë se kishte ndodhur shtytje. Në fakt, asnjë prej materialeve nuk përmban asnjë informacion apo opinion në lidhje me ndonjë rol apo përfshirje të Prokurorisë në prejardhjen ([REDAKTUAR],<sup>96</sup> [REDAKTUAR]) e Paketave. Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk konstatoi asnjë provë tjetër inkriminuese ose shfajësuese në materialet e sipërpërmendura.

60. Trupi Gjykses vëren më tej se materiali 185 nuk lidhet me asnjë aspekt ekzistues dhe nuk ngre asnjë aspekt të ri në këtë proces gjyqësor. Ndonëse materialet 186-190 dhe 192-194 përmbajnë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] ato nuk përmbajnë asnjë pretendim që mund të ketë lidhje apo që ka gjasa të ketë lidhje me një aspekt ekzistues, apo të ngrejë apo të ketë gjasa të ngrejë një aspekt të ri në çështjen gjyqësore aktuale. Rrjedhimisht, parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit se nxjerrja e këtyre materialeve është e nevojshme për të hulumtuar, ndër të tjera, besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë e dëshmimeve të dhëna, dhe mundësinë e zbulimit të provave të tjera,

---

<sup>93</sup> F00307/A01, f. 2.

<sup>94</sup> F00307/A01, f. 2-3.

<sup>95</sup> F00307/A01, f. 3-4.

<sup>96</sup> F00325/COR, para. 48.

nuk mund të merren parasysh,<sup>97</sup> sepse asnjë prej këtyre materialeve nuk do të kishte asnjë ndikim në argumentet e Mbrojtjes dhe në procesin aktual.

61. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se materialet 185-190 dhe 192-194 nuk janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes dhe nuk përfshihen në fushëveprimin e rregullës 102(3) të Rregullores. Duke pasur parasysh këtë konstatim, nuk është e nevojshme që Trupi Gjykses të vendosë nëse materialet e lartpërmendura përfshihen në fushëveprimin e rregullës 108(1) të Rregullores. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se materialet 186-190 përmbajnë informacione tejet të ndjeshme, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]. Po kështu, nxjerrja e materialeve 185-190 dhe 192-194 me gjasë do të cenonte hetimet aktuale të ZPS-së [REDAKTUAR].

## 2. Materiali 191

62. Trupi Gjykses vëren se materiali 191 është [REDAKTUAR]. ZPS-ja parashtron se ai është një material i brendshëm pune.<sup>98</sup>

63. Trupi Gjykses rikujton se rregulla 102 e Rregullores nuk përmban ndonjë përjashtim për mosnxjerrjen e materialeve të brendshme të punës në përputhje me rregullën 106 të Rregullores. Kjo sepse, sikurse është e qartë nga rregulla 106, materiale të tilla nuk janë objekt i nxjerrjes apo njoftimit, përveç nëse përfshihen në rregullën 103 të Rregullores ose nxjerrja e tyre urdhërohet nga Trupi Gjykses.<sup>99</sup> Përfshirja ose jo e një dokumenti në fushëveprimin e rregullës 106 të Rregullores nuk varet nga titulli i dokumentit, por nga përmbajtja, funksioni, qëllimi dhe burimi i tij. Dokumentet që përbëjnë materiale të brendshme pune zakonisht përmbajnë “mendimet dhe punën origjinale” të punonjësve të palës përkatëse<sup>100</sup> dhe çdo nxjerrje

---

<sup>97</sup> F00325/COR, para. 49-51.

<sup>98</sup> F00307/A01, f. 3, poshtëshënimi 2.

<sup>99</sup> Urdhri lidhur me Rregullën 102(3), para. 21. *Shih gjithashtu* rregullën 106 të Rregullores.

<sup>100</sup> Në mënyrë të ngjashme, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, Trial Chamber, [Reasons for the Trial Chamber's Decision Dismissing the Sabra Defence Application to Order Prosecution Disclosure of Documents Related to Mr Michael Taylor](#), 13 July 2018, para. 28.

e këtyre dokumenteve “duhet të jetë me natyrë të kufizuar dhe nuk mund të shërbejë për të cenuar qëllimin e kësaj rregulle, që është mbrojtja e shkëmbimit të lirë të ideve dhe diskutimet e hapura” midis punonjësve të asaj pale.<sup>101</sup>

64. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialit 191, Trupi Gjykses është i mendimit se, edhe në qoftë se ky dokument dhe përmbajtja e tij përbën material të brendshëm pune sipas rregullës 106 të Rregullores, Trupi Gjykses do të duhet të urdhërojë nxjerrjen e disa pjesëve të caktuara të tij në pajtim me atë rregull, me qëllim që të garantohet drejtësia e procesit dhe që Mbrojtjes t’i mundësohet hulumtimi i efektshëm i pretendimit të saj për shtytje në përputhje me standardin e GJEDNJ-së të diskutuar më lart. Ndonëse materiali 191 nuk përmban asnjë informacion të qartë që mund të ndihmojë pretendimin e Mbrojtjes apo hetimet e saj lidhur me shtytjen, ai është në vetvete një informacion që lidhet drejtpërdrejt me hapat hetimorë të ndërmarrë nga ZPS-ja për të përjashtuar mundësinë se kishte ndodhur shtytje. Sikurse e pranon edhe ZPS-ja, materiali 191 përmban [REDAKTUAR].<sup>102</sup> Kjo në vetvete ka të bëjë me pyetjen nëse ZPS-ja ndërmori hapa të arsyeshëm për të përjashtuar mundësinë se kishte ndodhur shtytje dhe cilët ishin hapat që u ndërmorën konkretisht. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se materiali 191 është juridikisht thelbësor për përgatitjen e Mbrojtjes dhe përfshihet në fushëveprimin e rregullës 102(3) të Rregullores. Pasi ka bërë këtë konstatim, Trupi Gjykses do të vendosë nëse materiali 191 përfshihet në fushëveprimin e rregullës 108(1) të Rregullores.

65. Trupi Gjykses vëren se materiali 191 përmban informacion të ndjeshëm [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>103</sup> Trupi Gjykses vëren gjithashtu se materiali 191 përmban hollësi konkrete të mëtejshme [REDAKTUAR].

<sup>101</sup> Ngjashëm, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, Trial Chamber, [Reasons for the Trial Chamber’s Decision Dismissing the Sabra Defence Application to Order Prosecution Disclosure of Documents Related to Mr Michael Taylor](#), 13 July 2018, para. 27.

<sup>102</sup> F00389, para. 15.

<sup>103</sup> F00389, para. 15.

66. Trupi Gjykues rikujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekzistonte një dyshim i bazuar mirë që të akuzuarit, ndër të tjera: (i) morën pjesë qëllimisht në shpërndarjen e paautorizuar të informacionit të mbrojtur;<sup>104</sup> (ii) në mënyrë të përsëritur publikuan dokumente që kishin lidhje me ZPS-në/TFHS-në, që i ishin dhënë OVL-UÇK-së;<sup>105</sup> dhe (iii) premtuan se do të vazhdonin të publikonin informacione të tilla në të ardhmen,<sup>106</sup> megjithëse kishin marrë urdhër nga Gjykatësi i Vetëm për të mos e bërë këtë.<sup>107</sup> Trupi Gjykues mban parasysh se vendimi aktual duhet të ketë si pikënisje supozimin e pafajësisë së të akuzuarve. Megjithatë, Trupi Gjykues është i mendimit se konstatimet e mësipërme tregojnë se ekziston rreziku që, nëse do të kenë qasje në materialin 191, të akuzuarit mund të orvaten ta shpërndajnë informacionin që përmban ai. Gjithashtu, edhe nëse ky rrezik nuk do të ekzistonte, nxjerrja e plotë e atij materiali mund të cenonte hetimet aktuale të ZPS-së si rezultat i përdorimit të tij prej Mbrojtjes gjatë hetimeve lidhur me pretendimet për shtytje. Për këtë arsye, Trupi Gjykues mendon se nxjerrja e plotë e materialit 191 do të cenonte hetimin aktual të ZPS-së.

67. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të vlerësojë nëse ka masa kompensuese të cilat mund të ofrojnë masë ndreqëse adekuate për Mbrojtjen. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka propozuar si masë kompensuese që t'i japë Mbrojtjes pjesë nga materiali 191 [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>108</sup> Megjithëse i mirëpret këto propozime, Trupi Gjykues mendon se ato janë të pamjaftueshme për t'i mundësuar Mbrojtjes të verifikojë kontekstin përkatës të përpjekjeve të ZPS-së për përjashtimin e mundësisë që rrjedhja e informacionit të jetë bërë qëllimisht nga një punonjës i saj.

---

<sup>104</sup> F00074/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 11 dhjetor 2020, para. 100, 102-103, 105, 108-109, 111-113, 115-117.

<sup>105</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 101-102, 106, 108.

<sup>106</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 101-102, 106-108.

<sup>107</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 101-102, 106-108.

<sup>108</sup> F00389, para. 15-16.

68. Për këtë arsye, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që, në pajtim me rregullën 108(4) të Rregullores, të dorëzojë edhe pjesë të tjera nga materiali 191, sikurse përcaktohet në shtojcën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të këtij vendimi. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se pjesa e mbetur e materialit 191, e cila nuk i bëhet e ditur Mbrojtjes, nuk përmban prova të tjera inkriminuese ose shfajësuese, nuk lidhet me asnjë aspekt ekzistues, dhe nuk ngre ndonjë aspekt të ri në këtë gjykim.

### 3. Materialet 195-200

69. Trupi Gjykses vëren se materialet 195-200 janë të dhëna të thirrjeve telefonike (“të dhënat e thirrjeve telefonike”) [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]), [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]) [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]).

70. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton se ka marrë një përmbledhje të hapave dhe verifikimeve të ndërmarra nga ZPS-ja për të përjashtuar mundësinë që të dhënat e thirrjeve telefonike përmbanin indikacione që punonjës aktualë apo të mëparshëm të ZPS-së, apo cildo person që ka vepruar nën udhëzimin apo kontrollin e ZPS-së, t’ua ketë dhënë vullnetarisht informacionin në fjalë të akuzuarve (“Përmbledhja e Verifikimeve”).<sup>109</sup>

71. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të të dhënave të thirrjeve telefonike, Trupi Gjykses konstaton se ato, në vetvete, nuk e ndihmojnë pretendimin apo hetimin e Mbrojtjes lidhur me shtytjen. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se të dhënat e thirrjeve telefonike, në formatin origjinal të papërpunuar, nuk japin informacion për hapat hetimore të ndërmarrë nga ZPS-ja për të përjashtuar mundësinë e rrjedhjes së qëllimshme. Për më tepër, në pamje të parë, të dhënat e thirrjeve telefonike nuk duket se përmbajnë prova të tjera inkriminuese ose shfajësuese dhe as nuk duket se lidhen me ndonjë aspekt ekzistues apo ngrenë ndonjë aspekt të ri në gjykimin aktual. Megjithatë, Trupi Gjykses mendon se Mbrojtja, nga ana e saj, mund të porosisë kryerjen e analizës së të

---

<sup>109</sup> Paneli urdhëroi dorëzimin e kësaj përmbledhjeje në urdhrin F00320, para. 8 dhe 9(b). ZPS-ja e paraqiti përmbledhjen e këtyre verifikimeve në parashtrimin F00331, para. 3-6.

dhënave të thirrjeve telefonike dhe të nxjerrë përfundimet e veta në lidhje me hapat hetimorë të ndërmarrë nga ZPS-ja për të përjashtuar mundësinë që ka ndodhur shtytje. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se informacioni në të dhënat e thirrjeve telefonike ofron kontekstin përkatës të përpjekjeve të ZPS-së për të përjashtuar mundësinë e rrjedhjes së qëllimshme. Për këtë arsye, Trupi Gjykues konstaton se materialet 195-200 janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e Mbrojtjes dhe përfshihen në fushëveprimin e rregullës 102(3) të Rregullores. Pasi ka bërë këtë konstatim, Trupi Gjykues do të vendosë nëse materialet 195-200 përfshihen në fushëveprimin e rregullës 108(1) të Rregullores.

72. Trupi Gjykues vëren se materialet 195-200 përmbajnë të dhëna të thirrjeve telefonike konkrete që lidhen me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>110</sup> [REDAKTUAR].<sup>111</sup> Duke pasur parasysh deklaratat e të akuzuarve të paraqitura në paragrafin 66, Trupi Gjykues konstaton se ato tregojnë se ekziston rreziku që, nëse të akuzuarit do të kenë qasje në të dhënat e thirrjeve telefonike, ata mund të orvaten ta përhapin informacionin që përmbajnë ato. Për këtë arsye, Trupi Gjykues mendon se nxjerrja e plotë e materialeve 195-200 do të cenonte hetimin aktual të ZPS-së.

73. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të vlerësojë nëse ka masa kompensuese të cilat mund të ofrojnë masë ndreqëse adekuate për Mbrojtjen. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka propozuar si masë kompensuese që t'i japë Mbrojtjes Përmbledhjen e Verifikimeve. Trupi Gjykues mendon se Përmbledhja e Verifikimeve ofron kontekstin përkatës që tregon llojin dhe shkallën e hapave hetimorë të ndërmarrë nga ZPS-ja për të përjashtuar mundësinë që ka ndodhur shtytje. Bazuar në këtë, Trupi Gjykues konstaton se marrja nga Mbrojtja e Përmbledhjes së Verifikimeve përbën një masë kompensuese të përshtatshme në pajtim me rregullën 108(2) dhe (4) të Rregullores.

---

<sup>110</sup> F00389, para. 14.

<sup>111</sup> F00389, para. 14.

74. Për këtë arsye, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në t'i japë Mbrojtjes Përmbledhjen e Verifikimeve.

#### 4. Materiali 201

75. Trupi Gjykses vëren se materiali 201 përmban një notë zyrtare lidhur me kontaktin me një dëshmitar, ku ai, ndër të tjera, bën të ditur [REDAKTUAR].<sup>112</sup>

76. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialit 201, Trupi Gjykses konstaton se ai lidhet drejtpërsëdrejti me pretendimet për shtytje. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje fjalët e dëshmitarit në materialin 201, se [REDAKTUAR].<sup>113</sup> Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se nxjerrja e plotë e atij informacioni mund të ketë pasoja për sigurinë dhe/ose hetimet sipas rregullës 108 të Rregullores. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do ta shtyjë shqyrtimin e këtij materiali deri sa ZPS-ja të ketë ndërmarrë hapa të tjerë, sikurse përshkruhet në vijim.

77. Trupi Gjykses mban parasysh masat kompensuese të propozuara nga ZPS-ja në lidhje me materialin 201.<sup>114</sup> Trupi Gjykses mendon se masat e propozuara nga ZPS-ja do t'i japin Trupit Gjykses më shumë informacion për materialin 201 dhe mund ta ndihmojnë atë në marrjen e vendimit lidhur me rëndësinë materiale dhe/ose mosnxjerrjen e tij.

78. Për këtë arsye, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të zbatojë masat e propozuara dhe t'i raportojë Trupit Gjykses për to deri më 12 nëntor 2021. ZPS-ja urdhërohet që në atë raport të paraqesë qëndrimin e saj lidhur me nxjerrshmërinë e materialit, kundërshtimet që mund të ketë për nxjerrjen e tij, si edhe masat kompensuese që propozon të zbatojë për pjesët e dokumentit që mendon se nuk duhet t'i nxjerrë.

---

<sup>112</sup> F00361, f. 2.

<sup>113</sup> F00361, f. 2.

<sup>114</sup> F00389, para. 13.



**E. MARRJA E MËTEJSHME NË PYETJE NGA MBROJTJA**

79. Duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, Mbrojtja urdhërohet që deri më 8 nëntor 2021 të bëjë të ditur nëse dëshiron të thirret përsëri W04841 për marrje të mëtejshme në pyetje prej Mbrojtjes. Ky urdhër nuk cenon kërkesën për masë ndreqëse që mund të bëjë Mbrojtja pasi Trupi Gjykues të ketë marrë vendim mbi rëndësinë materiale dhe/ose nxjerrjen e materialit 201.

**F. DYMBËDHJETË PYETJET E GUCATIT**

80. Në parashtrimin F00316, ZPS-ja argumenton se të gjitha materialet që trajtojnë 12 pyetjet e Gucatit janë përfshirë në Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3).<sup>115</sup> Mbrojtja e Gucatit parashtron se, ndonëse ZPS-ja mund të mos jetë e detyruar të krijojë dokumentacion të mëtejshëm për t'iu përgjigjur 12 pyetjeve të Gucatit, fakti që ajo nuk kreu hetimet përkatëse në lidhje me këto pyetje është informacion njëherazi relevant dhe i nxjerrshëm.<sup>116</sup>

---

<sup>115</sup> F00316, para. 49. Dymbëdhjetë pyetjet e Gucatit janë si vijon: (i) Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë ndihmuar në hartimin e materialit?; (ii) Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë pasur qasje në dokument në mënyrë elektronike?; (iii) Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë pasur qasje në dokumentin fizik?; (iv) A ka qenë i mbrojtur me fjalëkalim dokumenti? Në rast se po, cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) e kanë pasur fjalëkalimin?; (v) A punojnë ende për ZPS-në të gjithë punonjësit që kanë pasur qasje në dokument (ose që kanë pasur fjalëkalime)?; (vi) A ka ZPS-ja ende një kopje elektronike të dokumentit?; (vii) A janë bërë kërkime në meta të dhënat për të gjetur prova se cili ka qenë personi i fundit që ka pasur qasje në dokument? Në rast se po, cili ka qenë ky person?; (viii) A i ka identifikuar ZPS-ja kompjuterin/kompjuterat që janë përdorur për hartimin e dokumentit? Cili është/cilët janë përdoruesit e rregullt të këtyre kompjuterave? Ku ishin të vendosura këto pajisje?; (ix) A është intervistuar ndonjë punonjës apo ish-punonjës i ZPS-së lidhur me nxjerrjen e dokumentit?; (x) A janë analizuar të dhënat e ndonjë prej pajisjeve elektronike që përdorej ose ishte nën kontrollin e punonjësve ose ish-punonjësve të ZPS-së për të gjetur prova për nxjerrjen e dokumentit?; (xi) A janë analizuar të dhënat e ndonjë prej adresave të postës elektronike apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, që përdorëshin ose ishin nën kontrollin e punonjësve ose ish-punonjësve të ZPS-së për të gjetur prova për nxjerrjen e dokumentit (xii) A ka pasur kopje fizike të dokumentit të ruajtura në mjediset e ZPS-së? Në rast se po, a ka pasur mbulim me kamera sigurie në zona/zonat ku ruhej materiali ose rrugët që të çonin në këtë zonë apo ato zona? Në rast se po, a janë analizuar filmimet nga kamerat e sigurisë për të gjetur prova të hyrjes dhe daljes nga zona(t) në fjalë?

<sup>116</sup> F00325/COR, para. 56.

81. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se shumicën e 12 pyetjeve të Gucatit, Mbrojtja ia drejtoi W04841-shit<sup>117</sup> dhe ka të drejtë të bëjë të njëjtën gjë edhe në lidhje me W04842-shin ose W04876-ën.<sup>118</sup>

82. Trupi Gjykses është i mendimit se 12 pyetjet e Gucatit trajtohen nga masat kompensuese të urdhëruara nga Trupi Gjykses në lidhje me materialin 191, për aq sa ato kanë të bëjnë me informacion të nxjerrshëm sipas rregullës 102(3) të Rregullores.

83. Trupi Gjykses mendon gjithashtu se 12 pyetjet e Gucatit nuk janë mjaftueshmërisht konkrete dhe në fakt përbëjnë një “ekspeditë peshkimi” për informacion, çka është në mospajtim me Rregulloren. Sikurse është thënë më parë, Mbrojtja mund të kërkojë nxjerrjen e materialeve që nuk janë përfshirë në njoftimin sipas rregullës 102(3) por, në këtë rast, Mbrojtja duhet të japë parametrat e përshtatshëm për specifikimin e materialeve që kërkohen, në mënyrë që t’i mundësojnë ZPS-së të identifikojë materialet e kërkuara, si edhe duhet të tregojë rëndësinë materiale të informacionit të kërkuar për përgatitjen e Mbrojtjes.<sup>119</sup> Sistemi i nxjerrjes së materialeve nuk ka për qëllim t’i lejojë Mbrojtjes të detyrojë ZPS-në të krijojë materiale të nxjerrshme, apo që të rrëmojë në dokumentacionin e ZPS-së me shpresën e identifikimit të informacioneve relevante.

84. Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk do t’i trajtojë më tej 12 pyetjet e Gucatit.

## G. KËRKESAT SHITESË TË HARADINAJT

85. Në tri kërkesat shtesë të Haradinajt kërkohen: (i) të dhëna të punonjësve të ZPS-së të pranishëm gjatë operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit të datave 8, 17, 22 dhe 25 shtator 2020, përveç atyre që janë bërë të ditura deri më tani;<sup>120</sup> (ii) të dhëna të

---

<sup>117</sup> Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1216-1240.

<sup>118</sup> Transkripti, 18 tetor 2021, f. 817.

<sup>119</sup> Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1649-1650.

<sup>120</sup> Kërkesa e parë shtesë e Haradinajt është si vijon: (a) të dhëna të punonjësve të ZPS-së, përfshirë prokurorë, hetues, punonjës të sigurisë, personel mbështetës, të pranishëm gjatë operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit të datave 8, 17, 22 dhe 25 shtator 2021, përveç atyre që janë bërë të ditur tashmë, si edhe çfarëdo notash zyrtare, raporte, videofilmime.

ndonjë punonjësi ose të të gjithë punonjësve të ZPS-së që janë pushuar nga puna ose kontratat e të cilëve nuk janë zgjatur pas rrjedhjeve të pretenduara;<sup>121</sup> dhe (iii) një kopje të videoincizimit original të intervistës së 25 gushtit 2021, për të verifikuar gabimet e pretenduara në përkthimin e transkriptit të intervistës së W04866-ës.<sup>122</sup>

86. ZPS-ja parashtron se kërkesat shtesë të Haradinajt janë të pabaza dhe janë tregues i një “ekspedite peshkimi” për informacion.<sup>123</sup> Në lidhje me kërkesën e parë shtesë, ZPS-ja parashtron se identitetet e të gjithë punonjësve të ZPS-së të përfshirë në marrjen e Paketave janë bërë tashmë të ditura, me përjashtim të një përkthyesi, për të cilin janë zbatuar redakte standarde.<sup>124</sup> ZPS-ja shton se Mbrojtja ka mundur ta shikojë të gjithë videoincizimin e kontrollimit të datës 25 shtator 2020.<sup>125</sup> Sa i takon kërkesës së dytë shtesë, ZPS-ja parashtron se asnjë punonjës i ZPS-së nuk është pushuar nga puna dhe në rastet kur punonjësve të ZPS-së nuk u janë zgajtur kontratat, kjo nuk ka qenë asnjëherë për ndonjë arsye që lidhet me këtë çështje gjyqësore.<sup>126</sup> Në lidhje me kërkesën e tretë shtesë, ZPS-ja parashtron se korrigjimet në transkriptet e intervistës së W04866-ës janë të vogla dhe nuk ka asnjë dobi që videoja të rishikohet për korrigjime të këtij lloji.<sup>127</sup>

87. Në parashtrimin F00326, Mbrojtja e Haradinajt nuk i përgjigjet konkretisht parashtrimeve të ZPS-së.

88. Sa i takon kërkesës së parë shtesë, Trupi Gjyqësor vë në dukje parashtrimet e ZPS-së se i gjithë informacioni përkatës është nxjerrë. Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë provë

<sup>121</sup> Kërkesa e dytë shtesë e Haradinajt është si vijon: (b) të dhëna të ndonjë punonjësi ose të të gjithë punonjësve të ZPS-së që janë pushuar nga puna ose kontratat e të cilëve nuk u zgjatën pas rrjedhjeve të pretenduara, duke përfshirë – por jo vetëm – 25 anëtarët e personelit, ndër të cilët edhe 4 drejtues të ekipeve të punës, kontratat e të cilëve nuk u zgjatën pas dhjetorit 2020.

<sup>122</sup> Kërkesa e tretë shtesë e Haradinajt është si vijon: (c) për shkak të një numri gabimesh [të identifikuar] në përkthimin e transkriptit të intervistës së W04866-ës pas krahasimit të transkripteve në anglishte dhe shqipe, një kopje të videoincizimit original të intervistës së 25 gushtit 2021.

<sup>123</sup> F00316, para. 50.

<sup>124</sup> F00316, para. 51.

<sup>125</sup> F00316, para. 51.

<sup>126</sup> F00316, para. 53.

<sup>127</sup> F00316, para. 54.

apo informacion për të kundërshtuar ato parashtrime. Po kështu, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e trajtoi gjerësisht këtë aspekt me W04841-shin dhe Trupi Gjykses gjithashtu bëri pyetje në lidhje me këtë.<sup>128</sup> Sa i takon kërkesës së dytë shtesë, Trupi Gjykses vë në dukje parashtrimin e ZPS-së se nuk ka pasur asnjë përfundim kontrate të punonjësve të ZPS-së për arsye që lidhen me këtë çështje gjyqësore. Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë provë apo informacion për të vërtetuar të kundërtën. Sa i takon kërkesës së tretë shtesë, i kujtojmë Mbrojtjes së Haradinajt se rruga që duhet të ndiqet në këto raste është përmes një kërkesë për verifikimin e transkriptit.<sup>129</sup>

89. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se kërkesat shtesë të Haradinajt janë të pabaza.

#### H. KËRKESA PLOTËSUESE E GUCATIT

90. Mbrojtja e Gucatit parashtron se, duke i raportuar në mënyrë selektive komentet që pretendohet të ketë bërë Trupi Gjykses në seancën *ex parte* të 21 tetorit 2021, ZPS-ja duket se ka vepruar në shkelje të klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të atij informacioni.<sup>130</sup>

91. ZPS-ja përgjigjet se seancën në fjalë e përmendi në një mënyrë që është në pajtim me Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit.<sup>131</sup>

92. Trupi Gjykses nuk konstaton asgjë të papranueshme në përmendjet nga ZPS-ja të udhëzimeve të Trupi Gjykses në seancën *ex parte* të 21 tetorit 2021 dhe mendon se parashtrimet përkatëse nuk bien ndesh me qëllimin e klasifikimit të asaj seance.

93. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa Plotësuese e Gucatit është e pabazë.

---

<sup>128</sup> Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1390-1407; Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1479-1489.

<sup>129</sup> Urdhër Gojor për Dorëzimin e Kërkesave të Mbetura për Përkthim ose Verifikim, 2 shtator 2021, f. 604.

<sup>130</sup> F00407, para. 24.

<sup>131</sup> F00409, para. 2, ku përmendet F00314, Trupi Gjykses, Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit, 17 shtator 2021.

## V. KLASIFIKIMI

94. Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të shumë prej aspekteve të trajtuara në këtë vendim dhe në diskutimet përkatëse në sallën e gjyqit lidhur me rregullën 102(3), Trupi Gjykues vlerëson se të gjitha parashtrimet e dorëzuara deri më tani duhet të vazhdojnë të mbajnë klasifikimin aktual. Trupi Gjykues do t'i rikthehet këtij konstatimi nëse dhe kur të jetë e përshtatshme.

**VI. VENDIM**

95. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** kërkesën e ZPS-së në lidhje me materialet 185-190 dhe 192-194;
- b. **URDHËRON** ZPS-në që deri më **5 nëntor 2021** t'i japë Mbrojtjes:
  - i. pjesë të materialit 191, sikurse përcaktohet në shtojcën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të këtij vendimi; dhe
  - ii. Përmbledhjen e Verifikimeve në lidhje me materialet 195-200;
- c. **URDHËRON** ZPS-në të zbatojë masat e propozuara në lidhje me materialin 201 dhe t'i raportojë Trupit Gjykses deri më **12 nëntor 2021**;
- d. **HEDH POSHTË** Kërkesat Shtesë të Haradinajt dhe Kërkesën Plotësuese të Gucatit; dhe
- e. **URDHËRON** Mbrojtjen që deri më **8 nëntor 2021**, të bëjë të ditur përmes një parashtrimi me gojë gjatë seancës gjyqësore, nëse dëshiron t'i bëjë pyetje të mëtejshme W04841-shit, duke pasur parasysh këtë vendim dhe urdhrin për nxjerrjen e materialeve që i është dhënë ZPS-së.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

E mërkurë, 3 nëntor 2021

Në Hagë, Holandë